

## KREU 5

### ZOTI SI SHPIRT

Shpirti i Zotit që i është dhënë trupit tonë nuk mund të durojë hidhërim apo detyrim.

#### **Bariu i Hermasë**

Kur Shpirti i Zotit zbret mbi një njeri dhe e mbulon me plotërinë e vërshimit të tij, atëherë shpirti i njeriut mbushet me një gëzim të papërshkrueshëm, sepse Shpirti i Shenjtë i jep gëzim çdo gjëje që prek.

Mbretëria e qiejve është paqe dhe gëzim në Shpirtin e Shenjtë.

Përfito paqe të brendshme dhe mijëra përreth teje do të gjejnë shpëtimin e tyre.

#### **Shën Serafimi i Sarovit**

#### ***Grusht i shtrënguar apo duar të hapura?***

Në muret e katakombeve të Romës hasim disa herë të pikturuar figurën e një gruaje që lutet; ajo quhet *Oransa*. Me sytë e ngulur në qiell, me duart e hapura e të ngritura lart. Kjo është një nga ikonat më të lashta të krishtera. Cilën paraqet: Virgjëreshën Mari, Kishën apo shpirtin që lutet? Apo ndofta që të tria bashkë? Sido që të interpretohet, kjo ikonë ilustron një qëndrim të krishterë themelor: qëndrimi i lutjes ose i thirrjes (*epiklesis*), i pritjes së Shpirtit të Shenjtë.

Ka tre pozicione që mund të marrim me duart tona, dhe çdonjëri ka domethënie e vet simbolike. Duart mund të jenë të mbyllura, grushtat të shtrënguar si një gjest provokues ose si një përpjekje për të shtënë diçka në dorë për t'a mbajtur shtrënguar. Kjo shpreh kështu agresivitet a frikë. Në skajin tjetër duart mund të varen të plogëta në të dy anët, as në mënyrë sulmuese dhe as lutëse. Ose ndryshe, si një mundësi e tretë, duart mund të jenë të ngritura lart si ato të *Oransës*, tashmë jo të shtrënguar por të hapura, jo më të plogëta por të gatshme të pranojnë dhuratat e Shpirtit të Shenjtë. Një mësim shumë i rëndësishëm për Udhën shpirtërore është të kuptojmë se si të lirojmë grushtat dhe të hapim duart. Çdo orë dhe minutë duhet të përvetësojmë veprimin e

*Oransës: në mënyrë të padukshme të ngremë duart e hapura drejt qiellit, duke i thënë Shpirtit: Eja.*

Gjithë qëllimi i jetës së krishterë është të bëhet shpirtprurëse, të jetojë brenda Shpirtit të Zotit, të marrë frymë nga Shpirti i Zotit.

### ***Era dhe zjarri***

Në Shpirtin e Shenjtë ka gjithnjë diçka mistike dhe të pakuptueshme, e cila e bën të vështirë të flasim ose të shkruajmë për të. Siç thotë Shën Simeoni, Teologu i Ri:

*Merr emrin e tij nga lënda ku prehet,  
sepse nuk ka emër dallues midis njerëzve.*

Gjetkë Shën Simeoni shkruan (në të vërtetë, jo duke iu referuar posaçërisht Shpirtit, por fjalët e tij i përshtaten shumë mirë personit të tretë të Trinisë):

*Është i padukshëm dhe asnjë dorë s'mund t'a kapë;  
I paprekshëm, dhe megjithatë bëhet i ndjeshëm kudo...  
Çfarë është ky? O mrekulli! Çfarë nuk është? Sepse nuk ka emër.  
Mes marrëzisë sime u përpoqa t'a rrok.  
Dhe mbylla derën duke kujtuar se e mbaj shtrënguar,  
Por shpëtoi dhe nuk munda t'a mbaj në gishtat e mi,  
Plot pikëllim, e lirova pëllëmbën  
Dhe e pashë përsëri brenda dorës sime.  
O çudi e parrëfyeshme! O mister i çuditshëm!  
Përse mundohemi kot? Përse endemi kot?*

Kjo rrëshqitje është e dukshme në simbolet që përdoren në Shkrimet e Shenjta për të ilustruar Shpirtin. Është si "erë e stuhishme" (Veprat 2:2): vetë emri i tij (në greqishte *pneuma*) do të thotë erë ose frymë. Ashtu siç i thotë Jezui Nikodhimit: "Era (ose shpirti) ku i teket fryn; i dëgjon oshëtimën, por nuk e di nga vjen dhe për ku shkon" (Joani 3:8). Dimë se era është atje mes pemëve, teksa vigjilojmë natën, e ndjejmë në fytyrat tona tek ecim mbi kodra. Por në qoftë se përpiqemi t'a kapim dhe t'a mbajmë brenda duarve, ajo humbet. Kështu ndodh edhe me Shpirtin e Zotit. Nuk mund t'a peshojmë dhe t'a masim Shpirtin apo t'a ruajmë brenda një kutie me dry dhe kyç. Në një nga poemat e tij Gerard Manley Hopkins krahason Virgjëreshën Mari me ajrin që thithim; e njëjta gjë ndodh edhe me Shpirtin. Ashtu si oksigjeni, Shpirti është

burim jete, "që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha", përherë rreth nesh, gjithmonë brenda nesh. Ashtu pikërisht si ajri ngelet i paparë nga ne por vepron si një mjet me të cilin shohim dhe dëgjojmë gjëra të tjera, kështu edhe Shpirti nuk na zbulon fytyrën e tij të vërtetë, por na tregon gjithmonë fytyrën e Krishtit.

Shpirti i Shenjtë përgjasohet gjithashtu në Bibël me zjarrin. Kur Ngushëllimtari zbrit mbi të krishterët e parë ditën e Pesëdhjetores, shpërthejnë "gjuhë në flakë zjarri që ndahen" (Veprat 2:3). Ashtu si era, edhe zjarri është i pakapshëm; i gjallë, i lirë, gjithmonë në lëvizje, nuk mund të matet, nuk mund të peshohet ose të kufizohet në caqe të ngushta. Ndjejmë ngrohtësinë nga flakët, por nuk mund t'i marrim dhe t'i mbajmë në duar.

E tillë është lidhja jonë me Shpirtin. Jemi të vetëdijshëm për praninë e tij, njohim fuqinë e tij, por nuk mund të paraqesim aq lehtë portretin e tij. Personi i dytë i Trinisë u trupëzua, duke jetuar si njeri mbi tokë; Ungjijtë na flasin për fjalët dhe veprat e tij, fytyra e tij na vështron nga ikonat e shenjta dhe kështu nuk është e vështirë t'a pikturojmë brenda zemrave tona. Por Shpirti nuk u trupëzua; fytyra e tij hyjnore nuk na u zbulua me pamje njerëzore. Kur flasim për personin e dytë të Trinisë, termi "gjeneratë" apo "lindet", që përdoret për të treguar prejardhjen e përhjetshme nga Ati, na sjell në mendje një ide të spikatur, një koncept të posaçëm, megjithëse shohim se ky koncept nuk interpretohet literalisht. Por termi që përdoret për të treguar lidhjen e përhjetshme të Shpirtit me Atin - "burim", nuk jep një ide të kthjellët dhe të caktuar. Është si një hieroglif i shenjtë që tregon një mister, por i pazbuluar ende krejtësisht. Termi tregon se marrëdhënia midis Shpirtit dhe Atit nuk është e njëjta me atë midis Birit dhe Atit; por cila është natyra e përpiktë e ndryshimit, nuk na është thënë. Kjo është e pamundur se energjia e Shpirtit të Shenjtë nuk mund të përcaktohet me fjalë. Duhet të përjetohet si përvojë e drejtpërdrejtë.

Por, megjithë këtë cilësi mistike të Shpirtit të Shenjtë, tradita ortodokse na sugjeron rrugë për t'a interpretuar. Së pari, Shpirti është një *person*. Nuk është vetëm një "breshëri hyjnore" (siç dëgjova dikur dikë t'a përshkruante), nuk është vetëm një fuqi e pandjeshme, por një nga tre personat hyjnorë të Trinisë dhe kështu, me gjithë këtë dobësi të dukshme për t'a kapur, mundemi dhe futemi në një lidhje personale "Unë - Ti". Së dyti, Shpirti si anëtar i tretë i Trinisë së Shenjtë, është *i barasvlershëm* dhe *i bashkamëshuar* me dy të tjerët; nuk është thjesht një funksion që varet nga të tjerët ose një ndërmjetës. Një nga arsyt kryesore, për të cilën kisha ortodokse hedh poshtë shtojcën latine të *Filioque* në Besore, sikurse teorinë tjetër perëndimore për "të buruarit e dyfishtë" të Shpirtit që ndodhet mbrapa kësaj shtese, është pikërisht frika jonë

se një mësim i tillë ndoshta i çon njerëzit drejt një *depersonalizimi* dhe *uljeje* të Shpirtit të Shenjtë.

Bashkëpërjetshmëria dhe barasvlefshmëria e Shpirtit është një temë që përsëritet shumë herë në himnet e së Kremtes së Pesëdhjetores:

*Shpirti i Shenjtë ishte gjithnjë, është dhe do të jetë,  
As nuk ka as fillim, as fund,  
Po është gjithmonë i renditur dhe i numëruar bashkë me Atin dhe me Birin;  
Jetë dhe jetëdhënës,  
Dritë dhe dritëdhënës,  
I mirë vetë dhe burim mirësie,  
Me anën e të cilit njihet Ati,  
Me anën e të cilit lavdërohet Biri dhe iu zbulohet të gjithëve.  
Një fuqi, një renditje,  
Një adhurim i Trinisë së Shenjtë.*

### **Shpirti dhe Biri**

Midis "dy duarve" të Atit, Birit dhe Shpirtit, ekziston një marrëdhënie e dyanshme, një lidhje shërbimi të ndërsjelltë. Shpesh ekziston një tendencë për të shprehur lidhjen e brendshme midis të dyve me një mënyrë të njëanshme, e cila fsheh këtë ndërsjelltësi. Krishti, thuhet, vjen i pari; pastaj, mbas Ngjitjes së tij në qiell dërgon Shpirtin në Pesëdhjetore. Por në të vërtetë, hallkat e ndërsjellta janë më komplekse dhe më të drejtpeshuara. Krishti na dërgon Shpirtin, por njëkohësisht Shpirti është ai që dërgon Krishtin. Le të kujtojmë dhe le të shtjellojmë disa nga shembujt trinikë që dhamë më sipër në vija të përgjithshme.

1. *Mishërimi/Trupëzimi.* Në Ungjillëzim Shpirti i Shenjtë zbret tek Virgjëresha Mari dhe ajo zë Fjalën. Sipas Besores, Jezu Krishti "u mishërua prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari". Këtu është Shpirti ai që dërgon Krishtin në botë.

2. *Pagëzimi.* Lidhja është e njëjtë. Ndërsa Jezui del nga ujërat e Jordanit, Shpirti zbret tek ai me pamjen e një pëllumbi; kështu është Shpirti që "urdhëron" Krishtin dhe e dërgon në misionin e tij në botë. Kjo bëhet më se e qartë nga ngjarjet që vijnë menjëherë mbas Pagëzimit. Shpirti udhëheq Krishtin në shkretëtirë (Marku 1:12), ku do të fillojë për të një periudhë prove për dyzetë ditë, para se të fillojë të predikojë. Kur Krishti kthehet në fund të betejës së tij,

ai është "Me fuqinë e Shpirtit" (Lluka 4:14). Fjalët e para fare të predikimit të tij prekin drejtpërdrejt faktin se Shpirti e dërgon; lexon pjesën nga Isaia (61:1), duke ia përshtatur tekstin vetes së tij: "Shpirti i Zotit është mbi mua, prandaj më leu me vaj. Më dërgoi t'iu lëçit lajmin gazmor të varfërve" (Lluka 4:18). Titulli i tij "Krisht" ose "Mesia" tregon pikërisht se është lyer nga Shpirti i Shenjtë.

3. *Shpërfytyrimi*. Edhe një herë tjetër Shpirti zbret mbi Krishtin, këtë herë jo si pëllumb por si një re drite. Pikërisht ashtu si më parë Shpirti dërgoi Jezuin në shkretëtirë dhe pastaj në predikimin e tij të përbotshëm, dhe më vonë e dërgon atë në "eksodin" e tij apo në vdekjen - flijim, në Jeruzalem (Lluka 9:31).

4. *Pesëdhjetorja*. Lindja e ndërsjelltë këtu lëviz në drejtim të kundërt. Gjer tani ishte Shpirti ai që dërgonte Krishtin, tani është Krishti i ngjallur që dërgon Shpirtin. Pesëdhjetorja përbën qëllimin dhe plotëson Mishërimin; me fjalët e Vladimir Lossky-t: "Fjala mori mish, në mënyrë që ne të pranojmë Shpirtin".

5. *Jeta e krishterë*. Megjithatë, ndërveprimi i "dy duarve" nuk përfundon këtu. Ashtu si Shpirti dërgon Birin në Ungjillëzim, në Pagëzim dhe në Shpërfytyrim, ashtu dhe Biri sipas radhës dërgon Shpirtin në Pesëdhjetore. Kështu mbas Pesëdhjetores është vepër e Shpirtit të sjellë dëshminë e Krishtit, duke e bërë Krishtin e ngjallur të pranishëm mes nesh. Në qoftë se qëllimi i Trupëzimit është dërgimi i Shpirtit gjatë Pesëdhjetores, qëllimi i Pesëdhjetores është vazhdimi i Trupëzimit të Krishtit brenda jetës së Kishës. Këtë pikërisht bën Shpirti, gjatë thirrjes (*epiklesis*), në shenjtërimin e Eukaristisë hyjnore dhe kjo lutje shenjtëruese shërben si një model dhe shembull për çfarë ndodh në gjithë jetën tonë me Krishtin.

"Aty, ku janë dy a tre të mbledhur në emrin tim, atje jam në mes tyre" (Mattheu 18:26). Si është Krishti i pranishëm midis nesh? *Nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë*. "Dhe unë do të jem me ju gjithmonë gjer në fundin e botës" (Mattheu 28:20). Por si Krishti është gjithmonë me ne? *Nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë*. Për arsye të pranisë së Ngushëllimitarit në zemrën tonë, nuk e njohim Krishtin nëpërmjet lidhesh të tërthorta apo si një të njohur që vjen nga një e kaluar e largët, për të cilin kemi të dhëna të faktuara nga dëshmi të shkruara, por e njohim drejtpërdrejt, këtu dhe tani, në të tashmen, si Shpëtimtarin tonë personal dhe mikun tonë. Bashkë me apostull Thomain, mund të pohojmë: "Zoti im dhe Perëndia im" (Joani 20 : 28). Nuk themi thjesht, "Krishti lindi" - dikur, shumë kohë përpara por themi "Krishti lindet"- tani në këtë moment, brenda zemrës sime. Nuk themi thjesht "Krishti vdiq" por "Krishti vdiq për mua". Nuk themi thjesht "Krishti u ngjall", por "Krishti është i ngjallur" - jeton *tani* për mua dhe

brenda meje. Kjo menjëhershëmi dhe kjo drejtpërdrejtje personale në marrëdhëniet tona me Jezuin, është pikërisht vepra e Shpirtit.

Pra Shpirti i Shenjtë nuk na flet për veten e tij, por na flet për Krishtin. "Kur Shpirti i së vërtetës do të vijë, - thotë Jezui në Darkën Mistike - do t'ju udhëheqë brenda gjithë së vërtetës; sepse ai nuk do të flasë për veten e tij... do të marrë nga çka është e imja dhe do t'ju tregojë (Joani 16:13 - 14). Këtu shpjegohet arsyeja e anonimitetit ose, më saktësisht, tejdukshmëria e Shpirtit të Shenjtë sepse ai nuk flet për vete për Krishtin e Ngjallur.

### ***Dhurata e Pesëdhjetores***

Për sa i përket dhuratës së Ngushëllimitarit ditën e Pesëdhjetores, tre gjëra janë veçanërisht mahnitëse:

Së pari, është një *dhunti për të gjithë njerëzit e Zotit*: "U mbushën të gjithë me Shpirt të Shenjtë" (Veprat 2:4). Dhuntia (*hárisma*) e Shpirtit nuk u jepet vetëm peshkopëve dhe klerit, por çdo të pagëzuari. Të gjithë janë shpirtprurës, të gjithë janë - në kuptimin më të përshtatshëm të fjalës - "karismatikë".

Së dyti, është një *dhuratë bashkimi*. "Ishin mbledhur të gjithë bashkë me një zemër në një vend (Veprat 2:1). Shpirti i Shenjtë bën të shumtët të jenë një Trup me Krishtin. Zbritja e Shpirtit në Pesëdhjetore kthen përmbys pasojat e kullës së Babelit (Gjeneza 11:7). Siç themi në një nga himnet e së kremtes në Pesëdhjetore:

Kur zbriti dhe përzjeu gjuhët,  
i përndau kombet i Larti;  
dhe kur përndau gjuhët e zjarrit,  
i thirri të gjithë në bashkim;  
dhe me një zë lavdërojmë Shpirtin e Tërëshenjtë.

Shpirti sjell unitet dhe mirëkuptim të ndërsjelltë, duke na bërë të zotë të flasim "me një zë". Shndërron individët në personë. Për bashkësinë e parë të krishterë në Jeruzalem, në periudhën menjëherë mbas Pesëdhjetores, thuhet se, "të gjitha i kishin të përbashkëta" dhe se "të gjithë sa kishin besuar kishin një zemër dhe një shpirt" (Veprat 2:44; 4:32); dhe ky duhet të jetë shembulli i një bashkësie të krishterë që mbart këtë frymë Pesëdhjetoreje në çdo epokë.

Së treti, dhurata e Shpirtit është një *dhuratë shumëllojshmërie*: gjuhët e zjarrit "ndahen" ose "pjesëtohen" (Veprat 2:3), dhe i ndahen drejtpërdrejt secilit. Shpirti i Shenjtë nuk na bën vetëm të gjithëve një, por bën dhe secilin nga ne të ndryshëm. Në Pesëdhjetore moria e gjuhëve nuk u zhduk, por pushoi së qenuri shkaku i ndarjes; ashtu si më parë, secili fliste gjuhën e tij, por me fuqinë e Shpirtit secili mundte të kuptonte të tjerët. Të jem shpirtprurës për mua do të thotë të kuptoj të gjitha veçoritë dalluese të personalitetit tim; do të thotë të bëhem vërtet i lirë, vërtet vetja ime mes qenies sime unike. Jeta brenda Shpirtit ka një larmi të pashtershme; nëse jeta jonë është e bezdisshme dhe monotone, kjo është se diçka nuk shkon mirë tek ne, jo tek shenjtëria. Siç vërente me bezdi një miku im prift, i cili shumë orë të ditës i kalonte duke dëgjuar rrëfime: "Sa keq që nuk ka mëkate të reja!". Por ka gjithmonë forma të reja shenjtërie.

### ***Etër shpirtërorë dhe të marrë***

Në trashëgiminë ortodokse veprimi i drejtpërdrejtë i Ngushëllimitarit mes bashkësisë së krishterë është i dukshëm në mënyrë të mahnitshme në dy trajta "shpirtprurëse", *plaku* ose ati shpirtëror, dhe *i marri tek Krishti*.

Plaku ose "burri i moçëm", i njohur në greqishte si *jeron* dhe në rusishte *stareç*, nuk është e nevojshme të jetë patjetër i moçëm nga vitet, por të jetë i mençur përse i përket përvojës së tij për të vërtetën hyjnore, dhe i bekuar me hirin e "atësisë shpirtërore", me dhunti për të udhëhequr të tjerët në Udhë. Ajo që u ofron fëmijëve të tij shpirtërorë nuk janë kryesisht udhëzime morale apo një kanun jetese, por një marrëdhënie personale. "Një *stareç*, thotë Dostojevski, është ai që merr shpirtin tënd, vullnetin tënd brenda shpirtit dhe vullnetit të tij". Nxënësit e at Zaharias thoshnin për të: "Ishte njësoj sikur mbante zemrat tona brenda duarve të tij".

*Plaku* është njeriu i paqes së brendshme që krahi tij mijëra shpirtra mund të gjejnë shpëtim. Shpirti i Shenjtë i ka dhënë, si frut i lutjes dhe i mohimit të vetvetes, dhuratën e largpamjes ose të aftësisë për të shquar, që e bën të zotin për të lexuar të fshehtat në zemrat e njerëzve; dhe kështu u përgjigjet, jo vetëm pyetjeve që i shtrojnë të tjerët, por gjithashtu pyetjeve - shpesh shumë themelore - që as që kishin menduar kurrë të pyesnin. Në kombinim me dhuntinë e aftësisë shquese ka dhe dhuntinë e shërimit - fuqinë për të përtërirë shpirtrat e njerëzve dhe disa herë dhe trupat e tyre. Këtë shërim shpirtëror e jep jo vetëm me këshillat e tij por edhe me heshtjen e tij dhe me vetë praninë e tij. Sado e rëndësishme që mund të jetë këshilla e tij, shumë më e rëndësishme është lutja e tij ndërmjetuese. I tërëson fëmijët e tij duke u lutur vazhdimisht

për ta, duke marrë gëzimet dhe hidhërimet e tyre sikur të ishin të vetat, duke ngritur mbi supet e tij barrën e fajësisë dhe të shqetësimit të tyre. Askush nuk mund të jetë *plak*, nëse nuk lutet me ngulm për të tjerët.

Nëse *plaku* është prift, zakonisht shërbimi i udhëheqësit shpirtëror është i lidhur ngushtë me misterin e rrëfimit. Por një plak, në kuptimin e plotë, siç përshkruhet nga Dostojevski apo shpjegohet me shembullin e at Zaharias, është diçka më tepër se një prift-rrëfyes. Një plak, në kuptimin e plotë, nuk mund të emërohet nga ndonjë autoritet i lartë. Ajo që ndodh është thjesht se Shpirti i Shenjtë, duke folur drejtpërdrejt në zemrat e të krishterëve, zbulon se ky apo ai person është bekuar nga Zoti me hirin për të drejtuar dhe shëruar të tjerët. Plaku i vërtetë me këtë kuptim është një figurë profetike dhe jo një funksionar zyrtar. Megjithëse shumë rëndom është priftmurg, mund të jetë gjithashtu prift i martuar, ose një murg i thjeshtë që nuk është prift, ose madje - por kjo është më pak e zakonitë, një murgeshë ose një laik, burrë a grua, që jeton jashtë në botë. Nëse plaku nuk është prift vetë, mbasi dëgjon problemet e njerëzve dhe u jep këshilla dhe ndihmë shpirtërore e psikologjike, shpesh i dërgon tek prifti për misterin e rrëfimit dhe ndjesën e mëkateve.

Lidhja midis fëmijës dhe atit shpirtëror ndryshon shumë. Disa vizitojnë një plak ndofta vetëm një herë a dy gjatë gjithë jetës së tyre, në një moment veçanërisht kritik, ndërsa të tjerë janë në kontakt të rregullt me plakun e tyre duke e takuar çdo muaj ose madje dhe çdo ditë. Norma nuk mund të futen nga më parë; lidhja zmadhohet vetëm nën drejtimin e drejtpërdrejtë të Shpirtit.

Gjithmonë marrëdhënia është personale. Plaku nuk jep udhëzime abstrakte të mësuara nga ndonjë libër, ashtu si në rastin e kundër'reformës së katolikëve, por sheh në çdo rast atë burrë a grua që ndodhet para tij; dhe i ndriçuar nga Shpirti, përpiqet të përçojë vullnetin unik të Zotit posaçërisht për këtë person. Meqenëse plaku kupton dhe respekton karakterin e veçantë të secilit, nuk shtyp lirinë e brendshme por e përforcon. Nuk synon për të imponuar një bindje mekanike, por i udhëheq fëmijët në shkallën e pjekurisë shpirtërore, ku mund të vendosin vetë. I tregon secilit fytyrën e vërtetë të tij a të saj, që më parë në pjesën më të madhe iu ishte e fshehur; dhe fjala e tij është krijuese dhe jetëdhënëse, duke e bërë tjetrin të zotin për të arritur vepra që më parë i dukeshin të pamundura. Por të gjitha këto plaku mund t'i arrijë vetëm sepse secilin e do personalisht. Për më tepër marrëdhënia është e ndërsjelltë: plaku nuk mund t'a ndihmojë tjetrin në qoftë se ai nuk dëshiron seriozisht të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës dhe t'i hapë zemrën plakun me besim dashamirës. Ai që shkon për të takuar një plak me frymë kërsërie ka të ngjarë të kthehet me duar bosh, pa mbresa.

Meqenëse marrëdhënia është gjithmonë personale, një plak nuk mund të ndihmojë njësoj secilin. Mund të ndihmojë vetëm ata që janë dërguar posaçërisht tek ai nga Shpirti. Në të njëjtën mënyrë edhe nxënësi nuk duhet të thotë, "plaku im është më i mirë nga gjithë të tjerët". Duhet të thotë vetëm: "Plaku im është më i mirë për mua".

Në drejtimin e të tjerëve, ati shpirtëror pret vullnetin dhe zërin e Shpirtit të Shenjtë. "Jap vetëm çfarë Zoti më thotë të jap, tha shën Serafimi. Besoj se fjala e parë që më vjen është e frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë". Është e dukshme se askush nuk ka të drejtë të veprojë në këtë mënyrë, por vetëm nëse, me përpjekje asketike dhe lutje, ka fituar një vetëdije jashtëzakonisht të fuqishme të pranisë së Zotit. Për këdo që nuk ka arritur në këtë nivel, një sjellje e tillë do të ishte arrogante dhe e papërgjegjshme.

At Zaharia flet ashtu si shën Serafimi:

*Disa herë njeriu nuk di as vetë ç'të thotë. Vetë Zoti flet me buzët e tij; Ja si duhet të lutemi: "O Zot, jeto brenda meje, fol përmes meje, vepro mes meje. "Kur Zoti flet përmes buzëve të një njeriu, atëherë të gjitha fjalët e atij njeriu kanë efekt dhe çfarë thotë përmbushet. Vetë njeriu që flet habitet me këtë... Vetëm se askush nuk duhet t'i zërë besë urtësisë.*

Lidhja midis atit shpirtëror dhe fëmijës shtrihet përtej vdekjes, në gjykimin e fundit. At Zaharia i qetësoi nxënësit e tij: "Mbas vdekjes do të jem më i gjallë nga ç'jam tani, prandaj mos u hidhëroni kur të vdes... Ditën e gjykimit plaku do të thotë: *Ja unë dhe fëmijët*". Shën Serafimi kërkoi të skaliten në varrin e tij këto fjalë domethënëse:

*Kur të vdes, ejani tek unë në varrin tim, dhe sa më shpesh aq më mirë. Gjithçka që keni në shpirt, gjithçka që mund t'ju ndodhë, ejani tek unë, njësoj sikur të isha gjallë, dhe duke u gjuhëzuar në tokë, hidheni gjithë hidhërimin tuaj mbi varrin tim. Thuamëni çdo gjë dhe do t'ju dëgjoj; dhe gjithë hidhërimi do të ikë larg jush. Dhe siç më flisnit kur isha gjallë, bëjeni dhe tani. Sepse jetoj dhe do të jetoj përgjithmonë.*

Patjetër, jo të gjithë ortodoksët kanë atin e tyre shpirtëror. Por çfarë duhet të bëjmë kur kërkojmë një udhërrëfyes dhe nuk gjejmë asnjë? Natyrisht është e mundur të mësojmë nëpërmjet librave; nëse kemi apo nuk kemi plak, shikojmë Shkrimin për një udhërrëfim të vazhdueshëm. Por vështirësia me librat qëndron tek fakti se a jemi në gjendje të njohim saktësisht se çfarë më përshtatet mua personalisht në këtë pikë konkrete të udhëtimit tim. Përveç librave dhe përveç atësisë shpirtërore, ka gjithashtu vëllazëri shpirtërore -

ndihma që na jepet jo nga mësues tek Zoti, por nga bashkënxënësit tanë. Nuk duhet të lëmë pas dore rastet që na jepen në këtë formë. Por ata që ndjekin seriozisht Udhën përveç kësaj duhet të përpiqen me çdo mënyrë për të gjetur një at në Shpirtin e Shenjtë. Në qoftë se kërkojnë me përlësi, pa dyshim do t'u jepet drejtimi që kërkojnë. Natyrisht jo se do të gjejnë shpesh një plak si Shën Serafimi i Sarovit apo si at Zaharia. Duhet të kemi kujdes se mos teksa presim diçka më mbresëlënëse nga jashtë, nuk vëmë re ndihmën që me të vërtetë na jep Zoti. Dikush që në sytë e të tjerëve është i parëndësishëm ndoshta vërtetohet se është ai ati shpirtëror që mund të më thotë mua, *personalisht*, fjalët e zjarra që mbi të gjitha e kam të nevojshme t'i dëgjoj.

Një shpirtbartës i dytë profetik brenda bashkësisë së krishterë është i marri tek Krishti, i quajtur *salós* në greqishte dhe *iurodivyi* në ruseshte. Zakonisht është e vështirë të zbulojmë gjer ku "marrëzia" e tij është e vetëdijshme dhe e shtirur, dhe gjer ku e vetvetishme dhe e pavetëdijshme. I frymëzuar nga Shpirti, i marri arrin aktin e pendimit ose "të ndryshimit të mendjes" (*metánoia*) gjer në pikën më të largët. Më radikal nga kushdo tjetër, ai e zhvendos piramidën e mendësisë zotëruese me majë poshtë. Vetë ai është një dashuri e gjallë e së vërtetës, se mbretëria e Krishtit nuk është e kësaj bote; provon realitetin e "antibotës", mundësinë e së pamundurës. Ushtron vullnetarisht një varfëri të plotë, duke njëjtësuar vetveten me Krishtin e përlur. Siç thotë Julia de Beausobre: "Nuk është bir i askujt, vëllai i askujt, ati i askujt dhe nuk ka strehë". Duke braktisur jetën familjare, është endacaku apo shtegëtar që kudo ku shkon ndihet njësoj mirë, dhe megjithatë nuk ngulet kurrkundi. I veshur me lecka, madje dhe në palcë të dimrit, duke u shtrirë për të fjetur në ndonjë stallë a strehë kishe, ai mohon jo vetëm fitimet materiale por dhe çfarë të tjerët konsiderojnë si shëndet shpirtëror a ekuilibër mendor. Dhe megjithatë, kështu bëhet një kanal për urtësinë më të lartë të Shpirtit.

S'është nevoja të themi se i marri tek Krishti është një prirje jashtëzakonisht e rrallë; as është e lehtë të ndajmë shapin nga sheqeri. Ka në fund vetëm një dëshmi: "Nga pemët e tyre do t'i njihni ata" (Mattheu 7:20). I çmenduri i remë është i padobishëm dhe shkatërrimtar si për veten e tij ashtu edhe për të tjerët. I çmenduri i vërtetë tek Krishti, me shenjtërinë e zemrës, ushtron ndaj atyre që e rrethojnë një ndikim që e bën jetën më të mirë. Nga ana praktike nuk shërbehet asnjë dëshirë e dobishme nga gjithçka që bën i marri. Dhe megjithatë, me anë të një veprimi të befasishtëm a fjalë enigmatike, shpesh qëllimisht provokuese dhe tronditëse, i zgjon njerëzit nga vetëkënaqësia dhe farisaizmi. Duke qënë vetë i shpërqëndruar, ai shpërndan reagime ndaj të tjerëve, duke bërë nën'ndërgjegjen të ngjitet në sipërfaqe, në mënyrë që të mund të pastrohet dhe të shenjtërohet. Kombinon kokëkrisjen me përlësinë. Meqenëse ka mohuar gjithçka, është me

të vërtetë i lirë. Ashtu si i marri Nikolla i Pskovit, i cili vuri në duart e Ivanit të Tmerrshëm një copë mishi që pikonte gjak, i marri tek Krishti mund të qortojë ashpër të fuqishmit e kësaj bote me një guxim që të tjerëve u mungon. Ai është ndërgjegjja e gjallë e shoqërisë.

### ***Bëhu ajo që je***

Vetëm disa të krishterë në çdo brez bëhen *pleq* dhe akoma më pak bëhen *të marrë* në Krisht. Por *të gjithë* sa janë pagëzuar, pa përjashtim, janë shpirtbartës. "A nuk e koncepton dhe a nuk kupton dot bujarinë tënde?, pyesin *Ligjërimet e shën Makarit*: ... Secili nga ju është lyer me Mirosjen qiellore dhe është bërë një Krisht sipas hirit; secili është mbret dhe profet i mistereve qiellore".

Ajo që u bë me të krishterët e parë ditën e Pesëdhjetores ndodh dhe me secilin nga ne kur, menjëherë mbas Pagëzimit, sipas praktikës ortodokse, lyhemi me mirë. (*Mirosja*, misteri i dytë i Kishës Ortodokse, përkon me *Konfirmimin* në praktikën e traditës perëndimore). I sapopagëzuari - qoftë i mitur, qoftë i rritur - lyhet nga prifti në ballë, në sy, në hundë, në gojë, në vesh, në kraharor, në duar dhe në këmbë me fjalët: "Vula e dhuratës së Shpirtit të Shenjtë". Kjo është për secilin një Pesëdhjetore personale: Shpirti që zbriti dukshëm mbi apostujt, si gjuhë zjarri, zbret mbi secilin nga ne padukërisht, por jo me vërtetësi dhe fuqi më të vogël. Secili bëhet një "i lyer", një "Krisht" sipas ngjashmërisë së Jezuit, të Mesisë. Secili vulozet me dhuntitë e Ngushëllimitarit. Nga çasti i Pagëzimit dhe i Mirosjes sonë Shpirti i Shenjtë, bashkë me Krishtin, vjen të banojë në altarin më të brendshëm të zemrave tona. Megjithëse i themi Shpirtit "Eja", ai është më parë brenda nesh.

Sado të pakujdesshëm apo indiferentë që të jenë të pagëzuarit në jetën e mëvonshme, kjo prani e Shpirtit që jeton brenda tyre nuk tërhiqet kurrë plotësisht. Por ka të ngjarë që prania e Shpirtit brenda nesh të mbetet e strukturuar dhe e pavetëdijshme, përveç nëse bashkëveprojmë me hirin e Zotit, dhe nëse me ushtrimin e vullnetit tonë të lirë luftojmë për të zbatuar porositë. Si shtegtarë në Udhë, pra, kemi për qëllim të ecim nga stadi ku hiri i Shpirtit është i pranishëm dhe vepron brenda nesh në mënyrë të fshehtë, drejt shkallës së *njohjes së ndërgjegjshme*, ku njohim fuqinë e Shpirtit haptazi, drejtpërdrejt, me gjithë perceptimin e zemrave tona. "Erdha të vë zjarr mbi dhé, tha Krishti, dhe çfarë dua tjetër nëse tashmë është ndezur!" (Lluka 12:49). Shkëndia e frymës së Pesëdhjetores që është tek cilido nga ne nga pagëzimi, duhet të ndizet si një flakë e gjallë. Duhet të bëhemi ajo që jemi.

"Fruti i Shpirtit është dashuria, gëzimi, paqja, zemërgjerësia, mirësia..." (Galatasit 5:22). Njohja e ndërjegjshme e energjisë së Shpirtit duhet që të jetë diçka që të përshkojë gjithë jetën tonë të brendshme. Nuk është e nevojshme që secili të pësojë një "përvojë shndërruese" të çuditshme. Akoma më pak e nevojshme është për secilin "të flasë gjuhë". Shumica e ortodoksëve të sotëm e shohin me shumë rezerva atë pjesë të "Lëvizjes Pendikostiane" që u referohet "gjuhëve" si provë vendimtare dhe e domosdoshme për të qënë dikush me të vërtetë "shpirtprurës". Dhuntia "e gjuhëve" ishte pa dyshim e shpeshtë në epokën e Apostujve; por nga mesi i shekullit të dytë është pakësuar shumë, pavarësisht se kurrë nuk u zhduk plotësisht. Gjithsesi, Shën Pavli thekson se kjo është një nga dhuratat më pak të rëndësishme (Shih, 1 Korinthianët 14:5).

Kur "të folurit e gjuhëve" është me të vërtetë shpirtëror, ai ngjet se përfaqëson një akt "shpërthimi" - në momentin kritik teksa shembet vetëbesimi ynë mëkatar dhe të zëvendësohet me një gatishmëri për t'a lënë Zotin të veprojë brenda nesh. Në trashëgiminë ortodokse ky akt "shpërthimi" shumë shpesh merr trajtën e *dhuratës së lotëve*. "Lotët, thotë shën Isak Siriani, shenjojnë kufirin midis gjendjes trupore dhe asaj shpirtërore, midis gjendjes së nënshtrimit ndaj pasioneve dhe asaj të qashtërsisë". Dhe në një pasazh që ia vlen t'a përmendim shkruan:

*Pemët e njeriut të brendshëm fillojnë vetëm me shkrehjen e lotëve. Kur të mbërrish në vendin e lotëve, atëherë dije se shpirti yt ka dalë nga burgu i kësaj bote dhe ka filluar të ecë në monopatën që të çon drejt Jetës së Re. Shpirti yt fillon në këtë moment të thithë ajër të mrekullueshëm që ka atje, dhe fillon të derdhë lotë. Momenti për lindjen e fëmijës shpirtëror ka arritur dhe dhimbjet e lindjes bëhen më të mëdha. Hiri, nëna e përbashkët e të gjithë neve, shpejton të lindë fshehtësisht Shpirtin, imazhin e Zotit, duke e prurë në dritën e Jetës së amëshuar. Dhe kur ka ardhur koha për lindjen, mendja fillon të ndjejë diçka nga gjërat e asaj bote tjetër - si një aromë e hollë ose si fryma e jetës që një fëmijë i porsalindur merr brenda trupit të tij. Por nuk jemi të mësuar me një eksperiencë të tillë; dhe, duke e patur të vështirë për t'a duruar, trupi ynë befasisht shtrëngohet nga një e qarë përzier me gëzim.*

Por ka shumë lloje lotësh dhe jo të gjithë janë dhurata të Shpirtit. Përveç lotëve shpirtërorë, ka lotë zemërimi dhe lotë për ndonjë dështim, lotë që derdhen nga keqardhja për veten tonë, lotë sentimentale dhe emocionesh. Nevojitet aftësi shquese; që këtej fillon rëndësia për të kërkuar ndihmën e një udhërrëfyese shpirtëror me përvojë, një *plak*. Aftësia dalluese është akoma më e domosdoshme në rastin e "gjuhëve". Shpesh nuk është Shpirti i Zotit që flet brenda gjuhëve, por fryma krejtësisht njerëzore e vetësugjestionimit dhe e histerisë kolektive. Madje ka dhe raste kur "të folurit e gjuhëve" është një formë pushtimi demoniak. "Të dashur, mos u zini besë të gjithë atyre që pretendojnë

se kanë Shpirtin, por provojini ata për të vërtetuar nëse fryma që kanë vjen nga Perëndia" (1 Joani 4:1).

Si rrjedhojë, ortodoksia ndërsa thekson nevojën e një përvoje të drejtpërdrejtë të Shpirtit të Shenjtë, thekson gjithashtu nevojën për aftësi shquese dhe mendjekthjelltësi. Të qarët, ashtu si edhe pjesëmarrja në dhuratat e tjera të Shpirtit, është e nevojshme të pastrohet nga çdo fantazi dhe shkrehje sentimentale. Dhuratat që janë me të vërtetë shpirtërore nuk duhet t'i refuzojmë, por nuk duhet kurrë të synojmë dhurata të tilla si qëllim në vetvete. Qëllimi ynë brenda jetës së lutjes nuk është të fitojmë ndjenja apo eksperiencia "ndijimore" të një lloji të veçantë, por thjesht dhe vetëm të pajtojmë vullnetin tonë me vullnetin e Zotit. "Nuk kërkoj çka është e juaja, por vetë juve", u thotë Shën Pavli korinthisve (2 Korinthishet 12:14); dhe ne i themi njësoj Zotit. Nuk kërkojmë dhuratat, por Dhuruesin.

\* \* \*

## **Një thirrje drejtuar Shpirtit të Shenjtë**

Eja, dritë e vërtetë.

Eja, jetë e amëshuar.

Eja, mister i fshehur.

Eja, thesar i paemërtuar.

Eja, realitet tej çdo fjale.

Eja, person tej çdo kuptimi.

Eja, ngazëllim i pafund.

Eja, dritë e paperënduar.

Eja, pritja e sigurt e të shpëtuarve.

Eja, ngritje e të rënurve.

Eja, ngjallje e të vdekurve.

Eja, i gjithëfuqishëm, sepse papushim krijon,  
shndërron dhe ndryshon të gjitha vetëm me vullnetin tënd.

Eja, i padukshëm, që askush nuk mund të të prekë e të të mbajë në dorë,

Eja, sepse vazhdon gjithnjë të jesh i palëvizshëm,  
dhe megjithatë në çdo rast ndodhesh tërësisht në lëvizje;

vjen afër nesh që jemi në skëterrë, por qëndron më lart dhe nga qielli.

Eja, sepse emri yt mbush zemrat tona me dëshirë dhe është gjithmonë në buzët  
tona,

dhe megjithatë cili je dhe cila është natyra jote, nuk mund të themi apo të njohim.

Eja, i Vetëm tek e vetmja.

Eja, sepse ti vetë je dëshira që është brenda meje.

Eja, frymëmarrja ime dhe jeta ime.

Eja, ngushëllimi i shpirtit tim të përlulur.

Eja, gëzimi im, lavdia ime, kënaqësia ime e pafund.

### **Shën Simeoni, Teologu i Ri**

Shpirti i Shenjtë është dritë dhe jetë,

burim i gjallë mendor;

Shpirt i urtësisë.

Shpirt i mençurisë,

i mirësisë, i drejtësisë, shpirt mendor, prijës,

që pastron mëkatet,

Perëndi dhe hyjëzues;

zjarr që buron prej zjarri,

që flet, vepron, dhe ndan dhurata;

me anën e të cilit gjithë Profetët dhe Apostujt e Perëndisë

me Dëshmorët u kurorëzuan.

Lajm i çuditshëm, pamje e çuditshme, zjarr që përndahet në pjesë dhuratash.

### **Nga Mëngjesorja e Pesëdhjetores**

Çdonjëri që është pagëzuar në rrugë ortodokse, ka pranuar mistikisht mbushjen e hirit; dhe pastaj nëse vazhdon të ruajë porositë, do të fitojë vetëdijshëm njohjen e këtij hiri brenda tij.

Sado që të përparojë dikush në besim, sado bekime të mëdha që të fitojë, kurrë nuk zbulon, as do të mundet kurrë të zbulojë, asgjë më tepër nga ajo që ka marrë më parë mistikisht me pagëzimin.

Krishti, duke qenë Zot i përsosur, i dhuron të pagëzuarit hirin e përsosur të Shpirtit. Ne, nga ana jonë, nuk mund të shtojmë asgjë tek ky hir, por na zbulohet dhe na shfaqet gjithmonë e më tepër, në përpjestim me përmbushjen e porosive. Pra, gjithçka që i ofrojmë mbas rilindjes sonë, ishte më parë brenda nesh dhe rrodhi nga ai.

### **Shën Mark Murgu**

Personat hyjnorë nuk vetëshpallen, por njëri dëshmon për tjetrin. Për këtë arsye shën Joani i Damaskut tha se “Biri është imazhi i Atit dhe Shpirti imazhi i Birit”. Si rrjedhojë personi i tretë i Trinisë është i vetmi që nuk paraqitet në një person tjetër. Shpirti i Shenjtë, si person, qëndron i pashfaqur, i fshehur, duke struktur veten sapo duket...

Shpirti i Shenjtë është mirosja mbretërore e Krishtit dhe e gjithë të krishterëve që janë thirrur të mbretërojnë me të në Jetën e amëshuar. Atëherë, ky person hyjnor, i panjohur tani, pa pasur shëmbëllesën e tij në ndonjë anëtar tjetër të trinisë, do të shfaqet në personë të hyjnizuar; sepse moria e shenjtorëve do të jetë imazhi i tij.

**Vladimir Lossky**

Të gjitha i fal Shpirti i Shenjtë;  
buron profeci,  
përsos priftërinj,  
u fal të paditurve urtësi,  
peshkatarët i kthen në teologë,  
përmbledh tërë kanunin e Kishës.  
O Ngushëllimtar i bashkëqenshëm,  
dhe i bashkëfronshëm me Atin dhe me Birin,  
lavdi ty.

**Nga Mbrëmësorja e Rushajeve**